



Kolegji AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSES!

Fakulteti i Komunikimit Masiv – Gazetari

Studimet Master

Punim masteri

**SFIDAT E MEDIAVE NË KOSOVË GJATË
RAPORTIMIT PËR PANDEMINË COVID-19**

Kandidatja:

Bardhe SHKRELI

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Resul SINANI

Prishtinë, 2023

Abstrakti

Ky studim flet për ndryshimin e formës së punës së gazetarëve në Kosovë, gjatë pandemisë covid-19. Qëllimi ishte të shpalosnim sfidat me të cilat u përballen mediat, gjatë raportimit për sëmundjen infektive.

Gjetjet tona shpjegojnë se punonjësit medial, kanë punuar në një mjedis të pasigurt në aspektin shëndetësor e ekonomik. Po ashtu një pjesë e mediave, kanë punuar duke u zhvendosur nga zyra në shtëpi, kurse raportimi në distancë del të ketë sjellë disa vështirësi në punën e tyre.

Duke u mbështetur në shembuj nga komunikimi me gazetarë, ne shohim se mediumet kanë përdorur forma të ndryshme të organizimit të redaksive gjatë coronavirusit. Ndonëse, covid-19 i zuri mediumet të papërgatitura dhe pa njohuri të mjaftueshme për gjithë sistemin shëndetësor në vend, mediumet kanë arritur të transemtojnë informacione të verifikueshme dhe të besueshme për audiencat e tyre, duke iu shmangur dezinformimit apo keqinformimit. Në anën tjetër, përdorimi i telefoneve celularëka mundësuar raportimin e tyre në kohë reale, përkundër karantinimit.

Fjalë kyçe: gazetarë, redaktorë, media, raportimi, informacioni, pandemia, covid19.

Abstract

This study focuses on the change in the form of work of journalists in Kosovo, during the covid-19 pandemic. The aim was to reveal the challenges faced by the media when reporting on the transmittable diseases.

Our findings explain that media employees have been working in unsafe health and financial environment. In addition, some media houses adapted to working from home, although remote reporting has proved to be challenging at times due to movement restrictions.

Based on our communication with journalists, we have found out that some media have used different forms of editorial organization during the corona virus pandemics. Despite the fact that media in general was not prepared for the pandemic caused by the covid-19 and was not entirely aware of the health system issues in depth, they have managed to transmit verifiable and reliable information to their audiences, avoiding misinformation or inaccurate information. On the other hand, the use of mobile phones has made possible reporting in real time despite the quarantine.

Keywords: journalists, editors, media, reporting, information, pandemic, covid19.

DEKLARATË E AUTORËSISË

Përmbajtja e këtij punimi është tërësisht autoriale. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklaroj dhe marr përgjegjësi profesionale dhe morale se punimi im është punim autentik i punuar me përkushtim. Deklaroj se punimi është bazuar në intervista të gazetarëve, dhe është tërësisht autorial. Punimi nuk është i publikuar e as i përdorur për qëllime të kryerjes së obligimeve mësimore në ndonjë institucion arsimor.

Deklaroj se gjatë hartimit të këtij punimi, i kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të Kolegjit AAB.

Bardhe Shkreli

Prishtinë, më 12 dhjetor 2023

FALËNDERIM

Falënderoj gazetarët, redaktorët dhe përfaqësuesit e mediave, të cilët rrëfyen përvojën e tyre gjatë kohës kur vendi u përballë me pandeminë covid-19. Përvoja e tyre, shërbeu për të finalizuar këtë punim, prandaj, faleminderit! Një pjesëz e mirënjohjes është po ashtu, ndajmentorit Prof. Ass. Dr. Resul Sinani për bashkëpunimin dhe mbështetjen gjatë punimit të temës.

Ju FALEMINDERIT!

PËRMBAJTJA

Abstrakti.....	2
Abstract.....	3
DEKLARATË E AUTORËSISË.....	4
FALËNDERIM.....	5
LISTA E SHKURTESAVE.....	Error! Bookmark not defined.
PËRMBAJTJA.....	6
HYRJE	8
1.Qëllimi i hulumtimit	9
2.Objektivat e hulumtimit	10
3.Pyetjet që shtrohen.....	10
4. Rëndësia e temës.....	10
5. Metodologjia e hulumtimit	11
5. Përmbledhje.....	12
KAPITULLI I	Error! Bookmark not defined.
KONCEPTET TEORIKE RRETH LAJMIT DHE RAPORTIMIT NË KOHË KRIZASH	Error! Bookmark not defined.
1.1 Fillimi i pandemisë	Error! Bookmark not defined.
1.2. Studimet për median dhe pandeminë.....	Error! Bookmark not defined.
1.3 Raportimi në kohë krize.....	Error! Bookmark not defined.

1.4 Fake News në kohë pandemie.....	Error! Bookmark not defined.
1.5 Vështirësitë ekonomike të punonjësve të medias	Error! Bookmark not defined.
KAPITULLI II	Error! Bookmark not defined.
SFIDAT E GAZETARËVE GJATË RAPORTIMIT PËR PANDEMINË COVID-19	Error! Bookmark not defined.
2.1 Mungesa e gazetarëve të specializuar të shëndetësisë	Error! Bookmark not defined.
defined.	
2.2 Mungesa e masave të sigurisë dhe mjeteve mbrojtëse për gazetarët	Error! Bookmark not defined.
Bookmark not defined.	
2.3 Vështirësitë për të siguruar informacione nga burimet e informimit.....	Error! Bookmark not defined.
Bookmark not defined.	
2.4 Vështirësitë e realizimit të intervistave dhe emisioneve televizive me të ftuar në studio.....	Error! Bookmark not defined.
2.5 Përballja e mediave me Fake News	Error! Bookmark not defined.
2.6 Vështirësitë ekonomike të punonjësve të medimeve	Error! Bookmark not defined.
defined.	
KAPITULLI III.....	Error! Bookmark not defined.
ANALIZA DHE DISKUTIM	Error! Bookmark not defined.
KAPITULLI IV	Error! Bookmark not defined.
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	Error! Bookmark not defined.
4.1 Përfundime	Error! Bookmark not defined.
4.2 Rekomandime	Error! Bookmark not defined.

Literatura: 13

HYRJE

Shpërthimi i pandemisë Covid-19 zuri në befasi institucionet globale shëndetësore, që nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, institucionet kombëtare të kujdesit shëndetësor të të gjitha vendeve, si dhe qeveritë pa përjashtim. Ballafaqimi me të ishte sfidë edhe për Kosovën. Pra, s' do mend që njëpandemi e tillë, që i zuri të gjithë të papërgatitur, u paraqit si një sfidëe paprecedentë edhe për mediat, përkundër faktit të zhvillimit të tyre të jashtëzakonshëm teknologjik.

Shpërthimi i virusit dhe të panjohurat rreth tij shkaktuan panik në përmasa të përgjithshme në publik dhe kërkesa për informacion u rrit jashtëzakonisht shumë. Por, kriza preku edhe median. Më së shumti goditi shtypin ditor, duke e nxjerrë atë në tërësi nga tregu. Karantinimi dhe masat kufizuese preken edhe mediat e tjera, si televizionet, radiot dhe portalet. Burimet financiare të siguruara kryesisht nga reklamat që pësuan rënie drastike të të ardhurave për kompanitë mediatike bënë që disa medime të shkurtonin stafin e punëtorëve apo edhe pagat e tyre. Megjithatë, përpjekja e gazetarëve për të ushtruar profesionin e tyre vazhdoi, ani pse ata u gjenden në rrethana të jashtëzakonshme. Në radhë të parë, ata u përballën me frikën e infektimit, me burime të kufizuara, me mungesë qasjeje në ngjarje, me mungesë të masave mbrojtëse dhe në shumë raste edhe me paqartësi, pasi që në fillim shumë gjëra rreth pandemisë nuk janë ditur as nga shkencëtarët dhe as nga mjekët. Përveç rreziqeve për infektim dhe vështirësive ekonomike, reporterët dhe redaksitë u përballën edhe me vështirësi që ndikuan në cilësinë e raportimit. Megjithatë, duke qenë në gjendje të kuptonin seriozitetin e gjendjes së shkaktuar nga Covid-19 edhe mediat iu përshtaten rrethanave të kohës duke krijuar alternativa të reja për bashkëpunim me partnerët apo palët e interesit, me alternativa që do të trajtohen në këtë punim.

Sigurisht, pandemia Covid-19, në aspektin mediatik ishte ngjarja më prioritare, edhe për vetë faktin se preku të gjithë globin. Mënyrat e raportimit gjatë pandemisë ishin të ndryshme prej atyre që zbatohen në ngjarje të zakonshme. Ato ishin të ndryshme edhe nga mbulimet e luftës, konfliktit apo krizave, prandaj kjo ka shtuar edhe interesin për hulumtim. Modeli i raportimit për ngjarjet duke “respektuar distancën sociale”, që në shumicën e rasteve nënkuptonte mbulim të ngjarjeve nga distanca, është paraqitur edhe si sfidëpor edhe si provë se teknologjitë e reja të komunikimit në distancë janë bërë pjesë e të bërit gazetari. Pa dyshim, reporterët e televizionin kishin të tjera vështirësi në krahasim me reporterin e radios apo gazetarin e portalit, të cilat ky

punim synon t'i shpjegojë ashtu si këto dallime. Po ashtu, gjatë pandemisë, mediat janë kritikuar shpesh për fokusim të madh te shifrat e të infektuarve dhe vdekjeve, duke lënë në harresë faktin se sa e vështirë ishte qasja në burime të mirëfillta e po ashtu krijimi i burimeve të reja në kohën kur mbizotëronin shumë të panjohura. Sidoqoftë, gazetarët ja kanë dal që ato informacione që kanë plasuar të mos cilësohen si lajme të rreme, duke i bërë ata që të largohen nga ndërtimi i një raporti që përmban të pavërteta, Siç mund t'i hasim edhe sot në mediat e Kosovës.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij punimi është që të trajtojë disa prej sfidave me të cilat janë përballur mediat kosovare gjatë periudhës së pandemisë, si i kanë përballuar ato sfida dhe cilat kanë qenë pasojat e tyre. Hulumtimi është fokusuar nëdisa prej sfidave, siç janë: 1) mungesa e gazetarëve të specializuar të shëndetësisë, 2) mungesa e masave të sigurisë dhe mjeteve mbrojtëse për gazetarët nga mediat, 3) vështirësitë e sigurimit të informatave nga burimet e informimit që ishin të pakta dhe të kufizuara, 4) vështirësitë e realizimit të intervistave dhe emisioneve televizive me të ftuar në kushtet kur nuk lejohej lëvizja e lirë dhe kur rekomandohej distanca sociale, si dhe 5) përballja e mediave me lajme të rreme të cilat shkaktonin panik dhe pasiguri tek qytetarët.

Për më tepër hulumtimi analizon raportimin në distancë gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, më saktësisht për periudhën mars-gusht 2020. Pandemia largoi qasjen e mediave nga ngjarjet në terren, prandaj qëllimi kryesor në këtë punim ishte që të prezantojë vështirësitë që kanë pasur mediat gjatë raportimit në distancë. Meqë për herë të parë në vitet e pasluftës është shfaqur situatë e kufizimit të aktivitetit mediatic, është parë me interes të shohim edhe çfarë mënyra të raportimit janë përdorur për të plasuar informacionin në këto rrethana. Ndryshe, publikut i janë transmetuar informacione nga media të ndryshme, prandaj qëllimi është që të shohim edhe dallimin në mes të televizionit, radiove dhe portaleve. Në këtë kontekst për hulumtim janë përzgjedhur disa medime si:

- Kanalet televizive: RTK, KTV dhe Klan Kosova,
- Radiot: Radio Kosova 1, Radio Dukagjini dhe Evropa e Lirë,
- Portalet: Gazeta Express, Telegrafi dhe Kallxo.com.

Objektivat e hulumtimit

Të identifikojë dhe shpjegojë se cilat ishin sfidat kryesore me të cilat u përballen mediat gjatë periudhës së pandemisë Covid 19

1. Të identifikojë nëse mediumet kishin gazetarë të profilizuar për shëndetësi
2. Të identifikojë nëse gazetarët u pajisen me masa mbrojtëse me kohë
3. Të sqarohet prej nga i merrnin lajmet mediumet
4. Të sqarohet si realizoheshin intervistat me mysafirë
5. Të shpjegojë se si mediat përballeshin me FakeNeës
6. Të identifikojë nëse gazetarët u përballën me vështirësi ekonomike

Pyetjet që shtrohen

Cilat ishin sfidat kryesore me të cilat u përballën mediat dhe gazetarët gjatë pandemisë?

1. Sa ishin të përgatitura mediat për t'u përballur me një rrethanë të re të raportimit dhe sa kishin gazetarë të specializuar për shëndetësinë?
2. Në cilën fazë u pajisen gazetarët me masa mbrojtëse kundër sëmundjes?
3. Si reagueshan dhe si u transformuan mediat, në veçanti televizionet për të realizuar intervistat dhe emisionet me të ftuar në rrethanat e reja në të cilat nuk lejohej lëvizja e lirë (edhe e të ftuarve) dhe rekomandohej distanca sociale?
4. Prej nga i merrnin lajmet rreth sëmundjes covid-19, redaktorët?

Rëndësia e temës

Punimi i masterit, lidhur me sfidat e mediave gjatë raportimit për pandeminë Covid-19, është i një rëndësie të veçantë, në radhë tëparëpër faktin se ngjarja cilësohej botërore dhe e shtrirë si temë kryesore edhe në vendin tonëpër një kohë të gjatë. Së dyti, beteja me Covid-19, tejkaloj përmasat e një lufte në kuptimin shoqëror, pasi arriti të shmang gazetarin nga vendi i ngjarjes. Prandaj, në periudha të pazakonta, roli i mediave bëhet i jashtëzakonshëm.

Raportimi në distancë u paraqit si sfida për mediat në Kosovë, dhe jo e vetme. Sigurisht, rëndësia e kësaj teme qëndron edhe në aspektin etik të mediave, pra të raportimit të paanshëm të saktë dhe në kohë reale.

Sfidat me të cilat janë përballur gazetarët gjatë raportimit, nuk janë të njëjta për të gjithë punonjësit medial. Sipas, hulumtimit ato ndryshojnë, varësisht nga natyra e mediumit në të cilin kanë zhvilluar veprimtarinë ata. Sidoqoftë mediat e përfshira në hulumtim, kanë arritur të kuptojnë seriozitetin e situatës dhe janë treguar mjaft të kujdesshme, në përcjeljen e mesazheve te audiencat.

Metodologjia e hulumtimit

Në punim është përdorur metoda kualitative. Intervistat gjysmë të strukturura janë bërë me qëllim që t'u japin mundësi pjesëmarrësve në hulumtim të flasin për një numër çështjesh që lidhen me situatën covid-19, në të cilën operuan mediat. Të dhënat, si rrëfimet, historitë apo përvojat na ndihmuan për të analizuar performancën e mediave në kohë krize.

Metoda e intervistimit – Mbetët metoda kryesore e punimit. Përmes kësaj metode janë nxjerrë sfidat me të cilat janë ballafaquar mediat në pandemi gjatë periudhës mars - gusht 2020. Intervistat janë realizuar me reporterë që kryesisht kanë qenë të angazhuar gjatëperiudhës së karantinimit. Një cikël i intervistave është realizuar edhe me redaktorë, pasi të njëjtit ishin përgjegjës për organizimin e punës apo redaksive. Për qëllim të hulumtimit janë realizuar njëmbështjete intervista me gazetarë dhe nëntë me redaktorë.

Metoda përshkruese– Kjo metodë është përdorur për koncepte teorike apo tëshqyrtimit të literaturës së nevojshme. Përmes kësaj metode, është përshkruar se çfarë thuhet në vend për realizimin e punës së gazetarëve në kohë krize. Janë paraqitur disa kufizime të cilat ishin cilësuar gjatë pandemisë si masa parandaluese ndaj sëmundjes por edhe të dhëna që flasin për lajmet e rreme të shumta në atë kohë.

Metoda e analizës– Përmes kësaj metode janë analizuar të dhënat nga intervistuesit e përfshirë në hulumtim. Përmes analizës janë identifikuar sfidat më të cilat janë përballur mediat në kohë pandemie. Kjo ka mundësuar më pas, që të nxjerrim përfundime dhe rekomandime lidhur me situatën në të cilën kanë punuar mediumet.

Përmbledhje

Në kapitullin e parë është paraqitur një histori e shkurtër e shpërthimit të koronavirusit dhe identifikimit të sëmundjes. Më pas, janë trajtuar më gjërësisht konceptet teorike mbi median dhe punën e gazetarëve, me theks raportimi në kohë krize.

Në kapitullin e dytë jepen rrëfimet e redaktorëve dhe gazetarëve rreth sfidave me të cilat janë përballur ata, gjatë koronavirusit. Dhënia e shembujve konkret nga gazetarët e bënë më të qartë formën e punës së tyre në një rrethanë të pazakontë për median dhe shoqërinë në përgjithësi. Kufizimi i lëvizjes, raportimi në distancë, kontaktet me burimet e tyre, janë vetëm disa nga çështjet e evidentuara nga të intervistuarit, për këtë punim.

Në kapitullin e tretë janë analizuar sfidat me të cilat u përballen mediat kosovare gjatë pandemisë Covid 19. Përmes diskutimit është argumentuar mënyra që kanë përdorur mediat për të realizuar misionin e tyre për informim të publikut.

Ndërkaq në kapitullin e katërt jepen përfundimet e hulumtimit dhe rekomandimet që dalin pashmangshëm nga tema e punimit.

Literatura:

- Abrashi, G. & Reçi, A. (2023). Motivation of Employees in the Public Sector through Organizational Communication Case Study: Vala Mobile Company, Kosovo. *Journal Human Research in Rehabilitation*. 13(2), 313-320. <https://doi.org/10.21554/hrr.092314>
- Abrashi, G., & Sallauka, U. (2022). Use of Information Technology in Academic Library Practice. *The International Information & Library Review*, 54(4), 380–386. <https://doi.org/10.1080/10572317.2022.2124834>
- AGK, RAPORTIMI GJATË PANDEMISË DHE SIGURIA E PUNONJËSVE MEDIALË, Tetor, 2020.
- Aliu – Tahir, L. (2017). Komunikimi masiv dhe edukimi për media, Naimi , Tiranë.
- Brooks, B. S., Kennedy, G., Moen, D. R., & Ranly, D. (n.d.). *Missouri Group*. Tiranë: IKD.
- Cho, H. Li, P. Ngien, A. Grace Tan, M. Chen, A & Nekmat, Elmie (2023). Anët e ndritshme dhe të errëta të përdorimit të mediave sociale gjatë bllokimit të COVID-19. National Library of Medicine. Në dispozicion: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC10123536/>
- Demokracia Plus, Lajmet e rreme gjatë COVID-19 pandemia dhe ndikimi i saj në Kosova, Tetor 2021. Qasur në: <https://dplus.org/wp-content/uploads/2021/10/05-Policy-Brief-Fake-news-during-the-COVID-19-pandemic-WEB-ENG01-1-1.pdf>
- Desai, A., Nouvellet, P., Bhatia, S., Cori, A., & Lassmann, B. (2021). Data journalism and the COVID-19 pandemic: opportunities and challenges. *The Lancet Digital Health*, 3(10), e619-e621. [https://doi.org/10.1016/S2589-7500\(21\)00178-3](https://doi.org/10.1016/S2589-7500(21)00178-3)
- Deralla, XH, DORACAK GAZETARESK, Civil – Qendra për Liri, Autoprint T.A. – Shkup
- Fedler, F. Bender, J. Davenport, L. Grager, M (2005). Reporting for the Media, Eighth Edition, New York Oxford OXFORD UNIVERSITY PRESS.

Fuga, A, Marku. M, Këshilli Shqiptar i Medias dhe Fondacioni KonradAdenauer, Mediat dhe informimi i qytetarëve në kohën e koronavirusit, Tiranë, 2020

Gërguri, D. 2021, Mediet në Kosovë gjatë periudhës së COVID-19. Qasur në: <https://drengerguri.com/mediat-ne-kosove-gjate-periudhes-se-covid-19/>

Gërguri, D. TOP 5 dezinformatatnëgjuhëshqipelidhur me COVID-19.<https://drengerguri.com/top-5-dezinformatat-ne-gjuhen-shqipe-lidhur-me-covid-19/><http://presscouncil-ks.org/rekomandime-per-menyren-e-raportimit-ne-lidhje-me-covid-19/>

García-Avilés, J. A. (2021). Journalism as Usual? Managing Disruption in Virtual Newsrooms during the COVID-19Crisis. *Digital Journalism*, 9(9), 1239-1260. <https://doi.org/10.1080/21670811.2021.1942112>

Izmaku, Xh. & Gashi, Rr. (2023). The Impact of Social Media on the Development of Women Especially in Transition States. *HighTech and Innovation Journal* 4(3), 560-574. <http://dx.doi.org/10.28991/HIJ-2023-04-03-07>

Kameraj, R. 2020. COVID-19 igjetie dhe mediat e (pa)përgatitura.<https://kosovalive.org/2020/10/14/covid-19-i-gjeti-edhe-mediat-e-papergatitura/>

Këshilli Shqiptar i Medias& KONRAD ADENAUER STIFTIN, Tiranë , 2020

KosovaPress: <https://www.youtube.com/ëatch?app=desktop&v=5KB5zuzjhhs>

Luengo, M., & García-Marín, D. (2020). The performance of truth: politicians, fact-checking journalism, and the struggle to tackle COVID-19 misinformation. *American Journal of Cultural Sociology*, 8(3), 405-427. <https://doi.org/10.1057/s41290-020-00115-w>

Mach, K, Reyes, R, Pentz, B. Mbulimi mediatic i informacionit mbi shëndetin publik dhe politikat COVID-19, Dhjetor 2021. Qasur në:<https://pure.psu.edu/en/publications/news-media-coverage-of-covid-19-public-health-and-policy-informat>

- Muha, A (2014), RADIO NË PEIZAZHIN MEDIATIK SHQIPTAR. PROBLEME DHE PERSPEKTIVA. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë- Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit. Qasur në: <https://agk-ks.org/lajmet/raportimi-gjate-pandemise-dhe-siguria-e-punonjesve-mediale/>.
- MediaTuckCommunication, Hoë COVID-19 Will Change the Radio Industry (2023). Qasur në: <https://mediatracks.com/resources/hoë-covid-19-ëill-change-the-radio-industry/>
- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Ndikimi i dezinformimit dhe polarizimit politik gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, Prishtinë , qershor 2022.
- Papadopoulou, L., & Maniou, T. A. (2021).). “Lockdown”on Digital Journalism? Mapping Threats to Press Freedom during the COVID-19 Pandemic Crisis. *Digital Journalism*, 9(9), 1344-1366. <https://doi.org/10.1080/21670811.2021.1945472>
- United Nations (2021). Radioja ofron ngushëllim gjatë pandemisë COVID-19. Në dispozicion <https://www.un.org/en/coronavirus/radio-provides-solace-during-covid-19-pandemic>
- Saliu, H. (2024). Navigating media literacy in the AI era: Analyzing gaps in two classic media literacy books. *Journal of Applied Learning & Teaching*, 7(2), 98-109. <https://doi.org/10.37074/jalt.2024.7.2.25>
- Saliu, H.; Çipuri, R. & Izmaku, X. (2024). Gutenberg’s death in the Balkans: news values in Kosovo and Albania. *Cogent Arts & Humanities*, 11(1), 2303197. <https://doi.org/10.1080/23311983.2024.2303197>
- Saliu, H. (2023). Narratives of Public Diplomacy in the post-Truth Era: The decline of Soft Power. *Communication & Society*, 36(2), 209-224. <https://doi.org/10.15581/003.36.2.209-224>
- Saliu, H. & Abrashi, H. (2023). The Return of Media Diplomacy: Examples from Kosovo. *Jurnal Ilmu Sosial dan Ilmu Politik* 27(1), (74-89). <https://doi.org/10.22146/jsp.73710>
- Saliu, H., Reçi, A. & Abrashi, G. (2023). Revisiting Hallin and Mancini's media model: Albania and Kosovo. *Balkan Social Science Review*, 21. 235-255. <https://doi.org/10.46763/BSSR2321235s>

- Saliu, H. (2022). Rethinking Media Diplomacy and Public Diplomacy Towards a New Concept: Digital Media Diplomacy. *Online Journal Modelling the New Europe*, 39, 1-24. DOI: [10.24193/OJMNE.2022.39.01](https://doi.org/10.24193/OJMNE.2022.39.01)
- Saliu, H., Rexhepi, Z., Shatri, S. & Kamberi, M. (2022). Experiences with and risks of internet use among children in Kosovo. *Journal of Elementary Education*, 15(2), 145–164. [https://Doi.org/10.18690/rei.15.2.145-164.2022](https://doi.org/10.18690/rei.15.2.145-164.2022)
- Saliu, H., Bicaj, A. (2022). The Digital Competence of Future Teachers in Kosovo. In L. Tomczyk & L. Fedeli, (eds), *Digital Literacy for Teachers. Lecture Notes in Educational Technology*. Springer, Singapore. (275-290). [https://Doi.org/10.1007/978-981-19-1738-7_15](https://doi.org/10.1007/978-981-19-1738-7_15)
- Saliu, H. (2022). Public Diplomacy or Public Glocalization? Rethinking Public Diplomacy in the post-Truth Era. *Vestnik Moskovskogo universiteta. Seriya 10. Zhurnalistika*, 1, 157-175. DOI: [10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175](https://doi.org/10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175)
- Saliu H. & Lljunji V. (2022). Cultural Diplomacy of Kosovo after the Declaration of Independence. *Information & Media*, 93, 62-76. [https://Doi.org/10.15388/Im.2022.93.61](https://doi.org/10.15388/Im.2022.93.61)
- Saliu, H. (2021). The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave*, XXXVII(96–97), 189–207. <https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf>

Intervistat

Shefkiu, M. Redaktor në RTK. Intervistë përmes postës elektronike, 21 gusht, 2023.

Rexhepi, B. Redaktore në KTV. Intervistë përmes postës elektronike, 21 shtator, 2023.

Mifrari, Z. Redaktor në Klan Kosova. Intervistë përmes postës elektronike, 27 gusht, 2023.

Beha, B. Gazetar në RTK. Intervistë përmes postës elektronike, 04 korrik, 2023.

Voca, D. Gazetare në KTV. Intervistë përmes postës elektronike, 29 qershor, 2023.

Tahiri, B. Gazetare në Klan Kosova. Intervistë përmes postës elektronike, 13 korrik, 2023.

Uka, A. Gazetare në Klan Kosova. Intervistë përmes postës elektronike, 19 korrik, 2023.

Krasniqi, P. Redaktor në Radio Kosova. Intervistë përmes postës elektronike, 25 gusht, 2023.

Zejneli, A. Shefe e redaksisë në Radio Evropa e Lirë. Intervistë përmes postës elektronike, 12 shtator, 2023.

Sylmeta, L. Redaktor në Radio Dukagjini. Intervistë përmes postës elektronike, 16 shtator, 2023.

Çuni, P. Gazetar në Radio Kosova. Intervistë përmes postës elektronike, 08 korrik, 2023.

Kasapolli, A. Gazetare në Radion Evropa e Lirë. Intervistë përmes postës elektronike, 03 korrik, 2023.

Zymberi, K. Gazetare në Radio Dukagjini. Intervistë përmes postës elektronike, 10 korrik, 2023.

Krasniqi, N. Redaktor në Kallxo.com. Intervistë përmes postës elektronike, 03 gusht, 2023.

Hajrullahu, M. Redaktor në Telegrafi.com. Intervistë përmes postës elektronike, 29 gusht, 2023.

Veliu, B. Redaktor në Gazetaexpress.com. Intervistë përmes postës elektronike, 28 korrik, 2023.

Diellza, L. Gazetare në Kallxo.com. Intervistë përmes postës elektronike, 13 korrik, 2023.

Avdyli, B. Gazetar në Telegrafi.com. Intervistë përmes postës elektronike, 24 qershor, 2023.

Mifari, M. Gazetare në Kallxo.com. Intervistë përmes postës elektronike, 2 korrik, 2023.